

Politikat dhe Financat Publike

Orari:	E Merkure, 17:00-19:30
Klasa:	Online
Ligjërata e parë:	21 Tetor, 2020
Ligjërata e fundit:	20 janar, 2021
Ligjërues:	Rinor Beka, PhD Bernard Nikaj, PHD
Email:	rinor.beka@riinvest.net - bernard.nikaj@gmail.com
Administrata:	Rita Sekiraqa
Email:	rita.sekiraqa@riinvest.net
Tel:	+ 377 45 982 380

PËRSHKRIMI I LËNDËS:

Kjo lëndë ofron njohuri analitike dhe shkathtësi praktike që u mundëson studentëve të kuptojnë teorinë, qasjet, parimet dhe konceptet që ndërlidhen me politikat dhe financat publike. Pjesa e parë e lëndës mbulon konceptin e politikave publike, rrjetet e akterëve në procesin e politikëbërjes, tipologjinë e politikave publike, si dhe procesin e transferit e difuzionit të politikave në epokën e globalizimit. Në këtë pjesë trajtohen edhe aspektet e lidhshëm dhe menaxhimit strategjik në sektorin publik, si dhe sfidat me të cilat ballafaqohen institucionet publike të shteteve në zhvillim. Në pjesën e dytë të lëndës ofrohet një vështrim i përgjithshëm mbi shkencën e financave dhe të drejtën financiare. Lënda trajton konceptet, sistemet, proceset dhe procedurat që ndërlidhen me të hyrat publike, sistemet tatimore dhe taksat, shpenzimet publike dhe buxhetin e shtetit. Temat që mbulojnë nga lënda do të trajtohen edhe në kontekstin e Kosovës, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të njohin sistemin e qeverisjes, strukturën dhe përgjegjësitë e institucioneve të shtetit, ndërveprimin mes pushtetit qendror dhe lokal, dhe në përgjithësi procesin e zhvillimit të politikave dhe menaxhimit të financave publike.

REZULTATET E LËNDËS:

Pas vijimit të lëndës dhe përmbushjes së obligimeve të parapara studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë qasjet teorike, konceptet dhe praktikën e formësimit dhe menaxhimit të politikave dhe financave publike. Studentët do të mund të demonstrojnë njohuri mbi modelet e menaxhimit dhe administrimit të sektorit publik, konceptet e planifikimit dhe menaxhimit strategjik në sektorin publik, dhe organizimin e funksionimit të institucioneve qeverisëse dhe financiare. Gjithashtu, studentët do të avancojnë shkathtësitë analitike dhe do të jenë në gjendje të hartojnë dokumente të politikave si: koncept dokumente, hulumtime të politikave, dhe analiza buxhetore. Duke u mundësuar të kuptojnë kontekstin politik, ekonomik dhe social në të cilin zhvillohen dhe zbatohen politikat publike dhe duke avancuar shkathtësitë analitike dhe të shkrimit, lënda përgatitë studentët për të nisur dhe për të ndërtuar karrierë profesionale në institucionet publike, sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet ndërkombëtare.

PROGRAMI I LËNDËS:

Java	Tema	Aktiviteti
1.	Vështrim i përgjithshëm mbi lëndën. Orari, metodologjia, detyrat e studentëve dhe vlerësimi. Hyrje në politikat publike dhe studimin e politikave. Raporti mes shtetit, shoqërisë dhe politikës.	Ligjërata/ Diskutim
2.	Paradigmat ekonomike dhe qasjet ndaj shtetit të mirëqenies. Tensionet mes mirëqenies dhe efikasitetit ekonomike. Institutionet publike dhe akterët kryesor në bërjen e politikave publike.	Ligjërata/ Diskutim
3.	Modelet konceptuale të zhvillimit të politikave publike. Si formësohen politikat publike. Tipologjia e Politikave Publike?	Ligjërata/ Diskutim
4.	Cikli i zhvillimit të politikave publike: Vendosja e agjendës, formësimi i politikave dhe instrumentet për zbatim.	Ligjërata/ Ushtrime
5.	Zhvillimi i politikave publike bazuar në studime/hulumtime. Metodologjitë, qasjet dhe sfidat në zhvillimin e analizave të politikave publike. Si shkruhen dokumentet e politikave?	Ligjërata/ Ushtrime
6.	- Hyrje në Financat Publike - Eficienca Ekonomike, Drejtësia Sociale dhe Sundimi i Ligjit	Ligjërata/ Diskutim/
7.	- Të mirat publike dhe eksternalitetet - Roli i institucioneve të shtetit në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve publike	Ligjërata/Diskutim
8.	- Financat Publike dhe Drejtë Financiare - Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Ligjërata/ Guest Speaker
9.	- Modeli tradicional i administrimit të sektorit publik - Koncepti i Menaxhimit të Ri Publik - Menaxhimi Strategjik në sektorin publik	Ligjërata/ Diskutim
10.	Qasjet në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike në Kosovë. Procesi i politikëbërjes. Sistemi i qeverisjes, institucionet politike dhe burokracia.	Ligjërata/ Guest Speaker/ Diskutim

11.	Strategjitë kombëtare të zhvillimit, dokumentet e politikave publike, strategjitë legjislativë. Hierarkia e akteve juridike dhe procesi ligjvënës. Prezantimi i punimeve nga studentët	Ligjëratë/ Prezantime Diskutim/
12.	Ndikimi i strategjive zhvillimore, politikave publike dhe legjislativës në financat publike. Cikli i përgatitjes dhe struktura e buxhetit të shtetit. Prezantimi i punimeve nga studentët	Ligjëratë/ Diskutim
13.	Provimi i lëndës	

METODOLOGJIA E LËNDËS:

Në kuadër të metodologjisë së realizimit të lëndës do të ofrohen ligjërata klasike, diskutime grupore për materialet obligative për lexim, prezantime të studentëve, raste studimore, mysafirë për temat specifike, video materiale dhe vizita studimore. Për tema specifike do të ftohen edhe zyrtarë të institucioneve publike dhe sektorit të shoqërisë civile për të ndarë përvojën e tyre dhe për të bashkëbiseduar me studentët.

PJESËMARRJA, DETYRAT DHE VLERËSIMI

Pjesëmarrja në ligjërata është obligative. Prezenca dhe kontributi në diskutimet që zhvillohen gjatë ligjëratës janë faktor i rëndësishëm në vlerësimin përfundimtar për studentët. Prezenca dhe pjesëmarrja në ligjërata mund të sigurojnë 10% të notës përfundimtare. Esetë dhe punimet akademike mbi temat që do të trajtohen në kuadër të lëndës dhe prezantimi i tyre gjatë ligjëratave mund të siguroj deri në 30% të notës përfundimtare. Provimi i lëndës mund të siguroj deri në 60% të notës përfundimtare.

PLAGJIARIZMI DHE PANDERSHMËRIA AKADEMIKE

Kolegji Riinvest nuk toleron plagjiarizmin dhe pandershmërinë akademike dhe nga studentët pret të tregojnë integritet të lartë akademik. Punimet e dorëzuara nga studentët duhet të jenë të bazuara në të dhëna dhe dëshmi kredibile që bazohen në literaturën dhe studimet akademike për fushën specifike. Shfrytëzoni, në literaturën e sugjeruar në këtë syllabus, dhe burime të tjera relevante dhe gjithmonë sigurohuni të vendosni referencat përkatëse në punime tuaja, në përputhje me parimet dhe metodologjitë e shkrimit akademik. Për të shmangur plagjiarizmin zakonisht mjafton të shenjoni pjesët e caktuara të punimit apo të dhënat specifike të cilat i keni huazuar, dhe të referoni lexuesin se ku mund ta gjejnë burimin origjinal.

LITERATURA OBLIGATIVE:

Baliqi, Bekim. 2017. Politikat publike dhe qeverisja. Fondacioni Konrad-Adenauer. Prishtinë

Birkland, Thomas. 2015. *An Introduction to the Policy Process. Theories, Concepts, and Models of Policy Making* (third edition). Routledge. New York.

Bungo, Genta. 2004. *Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare*. Adel Print. Tiranë.

Arye L. Hilman. 2009. *Public Finance and Public Policy*. Cambridge University Press

Remzi Keco dhe Ilir Kapaj. 2012. *Administrimi publik. Cikël leksionesh*. Bledi, Tiranë.

Owen E. Hughes. 2003. *Public Management and Administration*. Palgrave

LITERATURA E REKOMANDUAR

Thomas R. Dye. 2017. *Understanding Public Policy*. Fifteenth Edition. Pearson Education, Inc.

Mochal Moran, Martien Rein and Robert E. Gooding. 2006. *The Oxford Handbook of Public Policy*. Oxford University Press

John Hudson and Stuart Lowe. 2009. *Understanding the Policy Process: Analysing Welfare Policy and Practice* (second edition). Bristol Policy Press

Christoph Knill and Jale Tosun. 2012. *Public Policy: A New Introduction*. Palgrave Macmillan

Harvey S. Rosen and Ted Gayer. 2007. *Public Finance*, Eighth Edition. New York: McGraw-Hill/Irwin.

Gruber, Jonathan. 2007 *Public Finance and Public Policy*, Second Edition. New York: Worth Publishers.

Kennett, Patricia. 2008. *Governance, Globalization and Public Policy*. Edward Elgar Publishing Limited

Michael Hill and Peter Hupe. 2009. *Implementing Public Policy: An Introduction to the Study of Operational Governance*. 2nd Edition, SAGE Publications

Gruber, Jonathan. 2007. *Public Finance and Public Policy*, Second Edition. New York: Worth Publishers

Daniele Caramani. Ed. 2014. *Comparative Politics*. 3rd edition. Oxford: Oxford University Press

Almond, Gabriel G. Bingham Powell, Russell Dalton, and Kaare Strom. Eds. 2010. *Comparative Politics Today: A World View*. 9th Edition. New York: Longman/Pearson

Francis Fukuyama. 2014. *Political Order and Political Decay: From the Industrial Revolution to the Globalization of Democracy*. Farrar, Straus, & Giroux

Rose, Richard. 2004. *Learning from Comparative Public Policy: A Practical Guide* Routledge

